



MBËSHTETJA E BE-SË PËR MAQEDONINË E VERIUT

INSTRUMENTE INVESTIMI



Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, miratuar nga Komisioni Evropian më 6 Tetor 2020*, synon të nxisë rimëkëmbjen ekonomike afatgjatë të rajonit, të mbështesë një tranzicion të gjelbër dhe digjital, për të nxitur integrimin rajonal dhe konvergjencën me Bashkimin Evropian. Plani krijon një paketë të konsiderueshme investimesh në mbështetje të ndërlidhjes së qëndrueshme, kapitalit njerëzor, konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse, dhe tranzicionit binjak të gjelbër dhe digjital. Paketa e investimeve do të jetë një faktor kryesor për lehtësimin e rritjes së investimeve publike dhe private në rajon nga institucionet financiare evropiane dhe ndërkombëtare.

*COM(2020)641 final



Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF), duke përfshirë edhe platformën e saj të sektorit privat **Programi i Zhvillimit dhe Inovacioneve të Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor (WB EDIF)**, mbledh partnerë të Ballkanit Perëndimor, donatorë bilateralë dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare në mbështetje të rritjes dhe konvergjencës së rajonit dhe vendeve individuale. WBIF u krijua në 2009, me Bashkimin Evropian si donator kryesor përmes Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA).

Ndihma e Para-Anëtarësimit (IPA II) gjithashtu ofron fonde shtesë si grante bilaterale direkt për Maqedoninë e Veriut, për të mbështetur projekte në fushat e transportit, energjisë, mjedisit, konkurrencës, inovacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve.

	WBIF grante 2009 - 2020	IPA II grante bilaterale 2014 - 2020
Transporti	€139.7m	€107.6m
Energjia	€30.8m	–
Mjedisi	€0.9m	€120.3m
Sociale	€9.8m	€44.3m
Infrastruktura digjitale	€0.6m	–
Konkurrenca dhe inovacioni përfshirë dhe bujqësinë	Ndarja e mbështetjes jepet në vijim	€164.6m
Totali	€181.8m	€436.8m
Mbështetja e BE-së për Maqedoninë e Veriut	WBIF grante + IPA II grante bilaterale €618.6m	



'Investimet e WBIF janë thelbësore për lidhjen e njerëzve, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e zhvillimit ekonomik në Maqedoninë e Veriut dhe të gjithë Ballkanin Perëndimor. Projektet WBIF sjellin përfitime të prekshme në jetën e njerëzve dhe përshpejtojnë integrimin e rajonit në BE.'

Ambasadori David Geer
Shefi i delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut

WBIF DHE MAQEDONIA E VERIUT

MAQEDONIA E VERIUT DHE KORNIZA E INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (WBIF)

WBIF ka qenë thelbësore në arritjen e përmirësimeve kryesore në jetën e përditshme të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut duke:

- Pilotimi i skemës së parë të rinovueshme në vend;
- Siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe konkurrent të energjisë për njerëzit dhe bizneset;
- Krijuar lidhjet kryesore të transportit rrugor dhe hekurudhor me vendet fqinje;
- Siguruar qasje në shërbime efikase të ujit dhe ujërave të zeza;
- Mundësuar shkolla dhe institucionet shëndetësore më të mira;
- Përmirësimi i sistemit të burgjeve.

Rezultatet

56 km të rrugëve

191 km të hekurudhave të rehabilituara dhe një pikë e përbashkët kufitare hekurudhore

238 km të linjave elektrike të përmirësuara

520 MW kapacitet gjenerues i energjisë së rinovueshme

Shkollat më të mira për 160,000 nxënës

Trajtimi shëndetësor dhe objektet kërkimore për 1.8 milion njerëz

Në Maqedoninë e Veriut, WBIF mbështet gjithashtu konkurrencën dhe inovacionin e sektorit privat (përfshirë bujqësinë) me investime të përziera (grante dhe hua) përmes instrumenteve të mëposhtme:

WB EDIF • financimi për NVM-të	€36.5m
EFSE • Investimet me hua të subvencionuara	€197.3m
GGF • Investimet me hua të subvencionuara	€36.7m
Totali	€270.5m

WBIF GRANTE	Grante investimi: €153.7m
€181.8m	Asistenca teknike: €28.1m
HUATË E FIRMOSURA	MBËSHTETJA E SEKTORIT PRIVAT
€591m	€270.5m
VLERA E VLERËSUAR E PROJEKTIT	PROJEKTE TË MBËSHTETURA
€2.1bn	23
Të dhënat nga Qershori 2020	

Qasja e NVM-ve në financa dhe konkurrencë

Programi i Zhvillimit dhe Inovacioneve të Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor (WB EDIF)

WB EDIF siguron qasje të diversifikuara në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs) përmes një sërë instrumentesh financiare, shoqëruar me shërbime këshilluese për të rritur gatishmërinë e investimeve të NVM-ve.

Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE)

EFSE nxit zhvillimin ekonomik përmes sigurimit të financave për institucionet e ndërmjetme huadhënëse të cilat u japin hua ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (NMV), fermerëve, agrobizneseve dhe ekonomive shtëpiake.

Efikasiteti i energjisë i sektorit privat dhe burimet e rinovueshme

Fondi për Rritje të Gjelbërt (GGF)

GGF financoon projekte të energjisë së rinovueshme përmes sigurimit të financave për institucionet e huadhënies së ndërmjetme që japin hua për NMV-të dhe ekonomitë private shtëpiake.

Programi Rajonal për Eficiência të Energjisë (REEP/REEP Plus)

REEP/REEP Plus ofron një kombinim të instrumenteve të financimit për komunat, NVM-të dhe ekonomitë shtëpiake për projektet e qëndrueshme të efikasitetit të energjisë.



Sektori Publik i WBIF • Përzjerja e investimeve për projektet kryesore të infrastrukturës



Korridori Orient/East-Med: Ndërlidhja rrugore Maqedonia e Veriut - Bullgaria CVIII, seksioni Kriva Palanka - Deve Bair

Maqedonia e Veriut përshkohet nga dy korridore kryesore ndërkombëtare, Korridori X dhe Korridori VIII, të cilët kanë një rëndësi thelbësore për lidhjen e vendit dhe tregtinë me BE-në dhe Ballkanin Perëndimor. Vetëm 36% të Korridorit VIII është në përputhje me standardet ndërkombëtare; seksioni ekzis-tues i rrugës nuk plotëson shpejtësinë e kërkuar të transportit prej 70 km/h. Projekti përfshin rindërtimin dhe rehabilitimin e një pjese rrugore prej 13.2 kilometrash në Korridorin VIII, nga Kriva Palanka deri në Deve Bair (vendka-limi kufitar me Bullgarinë). Projekti do të gjenerojë përfitime të konsideru-eshme përfshirë uljen e kostove të operimit të automjeteve, uljen e kohës së udhëtimit dhe përmirësimin e sigurisë rrugore dhe një ambient më të sigurt të udhëtimit.

BE grant: €2.5m

Hua nga BERZH: €10m

Investimi total: €13.7m



Fabrika e përpunimit të ujrave të zeza në Shkup

Vetëm 15% e Maqedonisë së Veriut merr shërbime nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. Qytetet më të mëdha si Shkupi akoma shkarkojnë ujëra të zeza të patrajtuara drejtpërdrejtë në lum, në këtë rast në Vardar, në rrjedhën më të gjatë ujore ndërkufitare në vend. Qëllimi i projektit është që të japë një kontribut të konsiderueshëm dhe të matshëm në përmirësimin e mjedi-sit urban të Qytetit të Shkupit dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza, p.sh., rritja e efikasitetit në trajtimin e ujëra-ve të zeza, pastrimi dhe eliminimi i llumit, përmirësimi i cilësisë së jetës për më shumë se 500,000 njerëz që jetojnë në qytet dhe në zonat e rrjedhës së poshtme.

BE grant: €0.5m

Hua nga EIB: €68m; Hua nga BERZH: €58m

Investimi total: €136.7m



Projekti pilot i Parkut të Energjisë me erë Bogdanci

Varësia e Maqedonisë së Veriut nga lëndët djegëse fosile do të thotë dëshirën e saj për të krijuar gjeneratën e re të energjisë së rinovueshme. Granti WBIF u përdor për të zhvilluar një studim të fizibilitetit për një fermë pilot të erës në Maqedoninë e Veriut. Studimi i fizibilitetit justifikoi një investim prej rreth 75 milion € në 25 makineri me një kapacitet total prej 52.5 MW, duke siguruar një burim të rinovueshëm të prodhimit të energjisë elektrike për rreth 7,000 ekonomi shtëpiake mesatare. Projekti do të shtojë kështu kapacitetin gjene-rues duke kontribuar në qëllimin e përmirësimit të sigurisë së furnizimit me energji, ndërsa në të njëjtën kohë do të zvogëlojë ndikimet negative mjedi-sore të përdorimit të energjisë dhe do të ndihmojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

BE grant: €0.4m

Huatë e KfW : €65.9m

Investimi total: €76m



Ndërtimi i objekteve të edukimit fizik në shkollat fillore dhe rehabilitimi i shkollave fillore dhe të mesme

Maqedonia e Veriut ka një mundësi shumë të kufizuara për edukimin fizik në shkolla, e demonstruar nga prapambetja e saj në treguesit krahasues rajonalë. Mbështetja e WBIF është pjesë e një programi të madh që synon nxitjen e zhvil-limit duke ofruar një mjedis më të mirë për të mësuar, përfshirë edukimin fizik përmes ndërtimit të 145 objekteve të edukimit fizik. Kjo do të sjellë përmirësime afatgjata në shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme. Përfituesit e drejtpërd-rejtë të kësaj asistence janë 11,000 fëmijë dhe 700 mësues.

Grantet e donatorit bilateral: €3m

Hua nga CEB: €42.5m

Investimi total: €62.6m

Sektori Privat i WBIF • Qasja në financa dhe konkurrencë, eficiencë të energjisë dhe burime të rinovueshme



Programi i Zhvillimit dhe Inovacioneve të Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor

Objektivi: Përmirësimi i kapacitetit dhe qasjes në financa të përballueshme për kompanitë në Ballkanin Perëndimor. Programi i Zhvillimit dhe Inovacioneve të Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndi-mor (WB EDIF) është platforma e udhëhequr nga BE për zhvillimin e sekto-rit privat në Ballkanin Perëndimor. Ajo bashkon palët kryesore të interesua-ra, duke përfshirë qeveritë e Ballkanit Perëndimor, INF-të, organizatat rajonale dhe donatorët bilateralë për të tërhequr dhe shfrytëzuar financimin dhe eks-pertizën së bashku. WB EDIF siguron qasje të diversifikuar në financa për ndër-marrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përmes një sërë instrumentesh financiare, (p.sh. Garancitë, kapitali, kreditë). Kjo shoqërohet me shërbime këshilluese për të rritur gatishmërinë e investimeve të NVM-ve dhe mbështetjen për reformat e politikave në rajon.

€36.5m të financimeve për NVM-të	✓
141 NVM të mbështetura në Maqedoninë e Veriut	✓
7 investime në kapital (€3.3m)	✓
Asistenca teknike dhe këshillëdhënëse për NVM për €3.9m	✓




Fondi Evropian për Evropën Juglindore*

Objektivi: Sigurimi i fondeve të qëndrueshme për ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe familjet me të ardhura të ulëta.

Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) është një fond publiko-privat i mbështetur nga BE i cili nxit zhvillimin ekonomik përmes sigurimit të financa-ve për institucionet e huadhënies të ndërmjetme që japin hua për NMV, përfshirë fermerët, agrobizneset dhe ekonomitë shtëpiake private. Struktura e tij të zhvillimit ofron asistencë teknike për të ndërtuar kapacitetin e një ekosistemi sipërmarrës (p.sh. sipërmarrësit, institucionet financiare, institucionet publi-ke). KfW është iniciatori dhe investitori kryesor i Fondit.

€197.3m të investimeve me hua të subvencionuara	✓
Mundësimi i 10,290 huave të subvencionuara	✓
33 projekte këshilluese të mbështetura	✓

*Numri dhe shuma e huave të subvencionuara nga fillimi



Cognism është një platformë e përshpejtimit të shitjeve e cila ndihmon ekipet e shitjeve B2B të përmirësojnë kërkimet dhe të gjenerojnë të ardhura të reja. Investimi prej 2.4 milion € i siguruar nga WB EDIF lejoi kompa-ninë të përshpejtojë rritjen e saj duke krijuar një ekip të dedikuar shitjeje për të nxitur zgjerimin e portofoleve të klientëve të saj dhe mundësinë për të forcuar ekipin e zhvillimit dhe për të përmirësuar zgjidhjen bazuar në reagimet e tregut.



Fondi për Rritje të Gjelbërt*

Objektivi: Mbështetja e masave rajonale për uljen e përdorimit të energjisë dhe emetimeve të CO₂ me 20%. Nën të njëjtën strukturë si EFSE, Fondi për Rritje të Gjelbërt (GGF) financo-n projekte të energjisë së rinovueshme. Institucionet e ndërmjetme të huadhënies ja-pin hua për ndërmarrjet mikro dhe të vogla (NMV) dhe për ekonomitë shtëpiake private. Fondi ka një fokus të veçantë në efikasitetin e energjisë dhe investimet në energjinë e rinovueshme. Asistenca e tij teknike mbështet NMV-të që të përgatisin projekte investimi dhe ndërtën kapacitetet e institucioneve të huadhënies së ndër-mjetme. Iniciatorët e GGF janë Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe Banka Zhvillimore KfW e Gjermanisë.

€36.7m të investimeve me hua të subvencionuara	✓
6,050 hua të subvencionuara	✓
161,899 MWh/vit të kursimeve kryesore të energjisë	✓
46,853 tCO ₂ /vit të uljes së emetimeve	✓

*Numri dhe shuma e huave të subvencionuara nga fillimi



Programi Rajonal i Eficiencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor**

Objektivi: Krijimi i një tregu të qëndrueshëm për eficiencën e energjisë në Ballkanin Perëndimor.

Programi Rajonal i Eficiencës së Energjisë për Ballkanin Perëndimor (REEP/ REEP Plus) ofron një kombinim të instrumenteve të financimit, asistencës tek-nike dhe dialogut të politikave për të adresuar pengesat në treg dhe për të sti-muluar zhvillimin afatgjatë të tregut. Zbatuar nga Banka Evropiane për Ri-ndërtim dhe Zhvillim (EBRD), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe KfW me mbështetjen e BE-së dhe donatorëve të tjerë bilateral, programi mbështet përmirësimin e mjedisit rregullator për investime në eficiencën e energjisë, ener-gjinë e qëndrueshme dhe të rinovueshme. Ai gjithashtu u lehtëson qasjen në financa bashkive, NVM-ve dhe ekonomive shtëpiake private.

140 milion € të huave të dhëna për financimin e projektit	✓
20,000 ekonomi shtëpiake që marrin financime	✓
Përmirësimi i eficiencës së energjisë	✓

**Rezultatet rajonale



Familja Popov nga Shkupi ka ndërtuar një shtëpi të re me ngrohje dhe izo-lim termik të përmirësuar. Janë përdorur dritare termikisht efikase, fasa-da dhe pompa të nxehtësisë ngrohje / ftohje, të cilat kursejnë energji dhe prodhojnë ngrohje dhe ftohje efikase gjatë gjithë vitit. Nëpërmjet Meka-nizmit për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër (GEFF) u sigurua një inves-tim prej 41,800€, i cili çoi në 86 MWh të kursimeve të energjisë në vit dhe uli ndjeshëm emetimet e CO₂.